

SHQIPËRIA NË DOKUMENTET AUSTRO-HUNGAREZE

VITI 1912

QENDRA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE
INSTITUTI I HISTORISË – TIRANË

**SHQIPËRIA NË DOKUMENTET
AUSTRO-HUNGAREZE**

(1912)

VËLLIMI VI

(nëntor – dhjetor)

Përgatitja dhe redaktimi

**Akad. assoc. MARENGLLEN VERLI
Dr. LEDIA DUSHKU**

Tiranë, 2012

Drejtues i Projektit

Akad. assoc. Marenglen VERLI

Redaktor përgjegjës i vëllimit:

Akad. assoc. Marenglen VERLI

Korrektimi i përkthimeve:

Dr. Edmond MALAJ

Korrektimi letrar:

Meliha BALLA

Arti Grafik:

Mirela MIHALI

Kopertina:

Dorina MUKA

MIRATUAR NË GRUPIN E PROJEKTTIT

© Copyright: QSA, Instituti i Historisë – Tiranë dhe përgatitësit

ISBN

Botimet Albanologjike

KY KORPUS DOKUMENTESH BOTOHET
ME RASTIN E 100-VJETORIT
TË SHPALLJES SË PAVARËSISË SË SHQIPËRISË

1912 - 2012

PARATHËNIE

Publikimi i dokumenteve historike për të kaluarën e shqiptarëve ka qenë dhe mbetet një detyrë e rëndësishme për historianët. Një gjë e tillë paraqitet veçanërisht e domosdoshme kur është fjala për ngjarje dhe dukuri me domethënie të jashtëzakonshme në historinë e shqiptarëve siç janë Kryengritja e Përgjithshme Antiosmane e vitit 1912 dhe Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë më 28 nëntor të këtij viti.

Viti 1912 është nga më të rëndësishmit në historinë moderne të kombit shqiptar. Ai nisi vrullshëm me mbledhjen e Taksimit në Stamboll në janar, ku u ngjiz ideja e Kryengritjes së Përgjithshme për të përfunduar me Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë, një akt që i çeli rrugë ndërtimit të shtetit të pavarur shqiptar. Ky akt dhe njohja e tij ndërkombëtare sanksionoi një të drejtë të ligjshme të kombit shqiptar për të cilën u luftua në shekuj, në mënyra e dinamika të ndryshme.

Për vetë peshën që ngjarjet e këtij viti mbartin, ato kanë qenë dhe janë objekt i një vëmendjeje të veçantë në letërsinë historike shqiptare dhe të huaj. Krahas studimeve të mirëfillta, një vend të rëndësishëm në përpilimin e sfondit historik zënë edhe burimet dokumentare të arkivave të shteteve të huaja, politika e të cilëve ka qenë e lidhur drejtpërsëdrejti ose tërthorazi me Shqipërinë e shqiptarët. Në këtë kuadër, dokumentet diplomatike austro-hungareze, janë një burim tejet i vlefshëm, në saje të të cilit ndriçohen deri në detaje lëvizjet politike e kulturore të shqiptarëve si dhe qëndrimi i faktorit ndërkombëtar ndaj çështjes shqiptare.

Në Arkivin e Institutit të Historisë pranë Qendrës së Studimeve Albanologjike, ruhet një fond i rëndësishëm i dokumenteve të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë (Haus und Hof Staats Archiv, Wien, Politisches Archiv, Albanien).

Zgjedhja për botim e këtij fondi, në kuadrin e 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, nuk ka qenë e rastit.

Së pari, ky fond përbën një nga seksionet më të kompletuara të Arkivit të Institutit të Historisë. Ai ka filluar të formohet që në vitet 30 me prurjet që synonin t'i shërbenin organizimit të festimeve të 25-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë dhe u pasurua në përmasat që zotërojmë sot në vitet 50-70, nën kujdesin e posaçëm të prof. Aleks Budës. Dokumentet e këtij fondi i kemi në shqip në saje të punës së kujdesshme dhe tejet të përkushtuar të një grupi përkthyesish: Veniamin Dashi, Henrik Lacaq, Maksut Shehu, Aleksandër Hivziu, Shefqet Hoti, Bexhet Shehu, Pjetër Rodiqi, Tomor Dani, Sh. Koka, J. Nuraj etj.

Së dyti, diplomacia austro-hungareze e fillimshkullit ishte nga më aktivet në rajon, madje në një hark kohor prej disa dhjetëravjeçarësh, që përfshin edhe periudhën e Rilindjes sonë Kombëtare edhe vitet pas Shpalljes së Pavarësisë deri në vitin 1918. E interesuar posaçërisht për Ballkanin, Perandoria Habsburgase shikonte me vëmendje të veçantë zhvillimet në trevat shqiptare ende nën sundimin osman, të cilat lakmoheshin nga shtetet e vogla ballkanike të krijuara përreth. Në këtë kuadër Perandoria ishte e pranishme me përfaqësi të shumta diplomatike në këto treva. Përveç ambasadës në Stamboll, ajo kishte kryekonsullata në qendrat e katër vilajeteve shqiptare, përkatësisht Shkodër, Manastir, Janinë e Shkup dhe konsullata në shumë qytete të tjerë.

Së treti, raportet konsullore austro-hungareze dallohen nga pikëpamja e thellësisë dhe gjerësisë së informacionit historik që serviret. Dokumentet, natyrisht, kanë edhe nota subjektivizmi por përsëri informacioni që na përcjellin është shumë i vyer, aq më tepër për arsye se diplomatët e Vjenës ishin njerëz të mirëarsimuar, njohës të profesionit të vet, me shumë përvojë. Njëherësh ata kishin në dispozicion mjete të rëndësishme monetare, që u siguronin në terren njohje të gjera dhe informacione nga burime të rëndësishme vendase.

Së katërti, i rëndësishëm për t'u theksuar është fakti se ky informacioni mbulon tërë hapësirën shqiptare, madje edhe vendet fqinje, ndodhitë e të cilave lidhen drejtpërsëdrejti ose tërthorazi me zhvillimet në vilajetet shqiptare. Një gjë e tillë shërben më së miri që lexuesit të krijojnë perceptime të sakta për ngjarje a dukuri të caktuara dhe më tej të qartësohen edhe për një kontekst më të gjerë të realitetit historik në vitin 1912.

Në dokumentet në fjalë gjenden të dhëna për tiparet e shqiptarëve, për virtytet dhe veset e tyre, madje sipas krahinave të ndryshme, mandej të dhëna për numrin dhe shtrirjen e tyre në planin etnik, për aftësitë e tyre, për

nivelin e zhvillimit ekonomik, social, për aspiratat politike, për situatën arsimore e kulturore, për botimet në gjuhën shqipe, etj. Perandoria Dualiste ishte e interesuar të kishte një informacion për gjithçka, madje dhe për politikën e shteteve ballkanike dhe të Fuqive të Mëdha me interesa në rajon, sepse mbi këtë bazë ndërtonte politikën dhe mbronte interesat e saj gjeostrategjike.

Sa i përket vitit 1912, ky fond ka të dhëna me interes për ngjarje, që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë lidhen me Kryengritjen e Përgjithshme të atij viti, me Luftën Ballkanike dhe me momentin e Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. Në këtë kuadër jepen informacione interesante për lëvizjet politike të shqiptarëve, veprimet kryengritëse në të gjitha trevat shqiptare, shqetësimin e ankthin, veçanërisht në elitën politike shqiptare për të ardhmen e vendit, përpjekjet e saj për të siguruar mbështetje në radhët e faktorit ndërkombëtar, veçanërisht të atyre Fuqive të Mëdha që për momentin ishin të pritura pozitivisht ndaj Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, etj. Në konstelacionin e zhvillimeve politike dhe ushtarake të kohës, lëvizjet edhe një mori personalitetesh politike shqiptare dhe shfaqen angazhime edhe të shumë Fuqive rajonale dhe evropiane, për atë çka po ndodhte në Shqipëri.

Dokumentet e këtij vëllimi përfshijnë periudhën kohore nga 5 nëntori deri më 7 dhjetor të vitit 1912, kohë kur përfundoi punimet Kuvendi Kombëtar i Vlorës. Ato japin të dhëna shumë interesante në lidhje me reagimin politik të shqiptarëve në kuadrin e Luftës së Parë Ballkanike, përgatitjet e tyre për organizimin e një kuvendi mbarëkombëtar. Ato bëjnë me dije se këto përpjekje nuk lidhen vetëm me iniciativën e Ismail Qemalit dhe bashkëpunëtorëve të tij, kryesisht në diasporë dhe as vetëm me mbështetjen e Austro-Hungarisë për realizimin e një Shqipërie autonome ose të pavarur, edhe pse këta i vunë vulën ngjarjes së njohur, duke marrë vlerësimet e merituar. Informacione me interes jepen edhe në lidhje me reagimin e qyteteve të Shqipërisë së Mesme në prag të pushtimit serb, shpalljen e pavarësisë dhe ngritjen e flamurit shqiptar aty. Atmosfera tejet entuziaste në Vlorë në ditët e mbajtjes së Kuvendit dhe vendimet e tij zënë një vend të rëndësishëm në vëllim. Të dhëna me interes ka edhe në lidhje me vështirësitë që haste qeveria e Vlorës në ditët e para të punës së saj, marrëdhëniet e vështira me shtetet fqinje dhe Perandorinë Osmane, etj.

Përgatitësit për botim kanë treguar një kujdes të veçantë që përmbajtja e dokumenteve të jepet e saktë, e qartë, duke e afruar gjuhën e përkthimit me atë letrare dhe duke ruajtur sa të ishte e mundur stilin e përkthyesit. Hera-

herës është ndërhyrë edhe me shënime e sqarime plotësuese brenda në tekst ose në fund të tij. Dokumentet botohen të plota me përjashtim të rasteve kur teksti në origjinal ka qenë i palexueshëm ose i fshirë, si edhe në ndonjë rast kur është vlerësuar se informacioni nuk ka pasur lidhje me botën shqiptare.

Së fundmi, është një kënaqësi t'u shprehet falënderim dhe mirënjohje studiuesve të gjeneratave të ndryshme të Institutit të Historisë, të cilët u angazhuan për pasurimin e fondeve të Arkivit të këtij Instituti me dokumentet diplomatike të Arkivit të Vjenës, si edhe, aktualisht me publikimin e tyre sipas kritereve shkencore bashkëkohore. Një falënderim e nderim i veçantë u shkon edhe përkthyesve, të cilët kanë dhënë një kontribut të çmuar për sjelljen në shqip të dokumenteve që po shohin sot dritën e botimit.

GRUPI I PROJEKTTIT

PËRMBAJTJA E DOKUMENTEVE

- 1 -

Telegram i Szögyény-t, ambasador i Austro-Hungarisë në Berlin, dërguar ministrit Berchtold, lidhur me miratimin e politikës austro-hungareze në Ballkan nga perandori Wilhelm i Gjermanisë

Berlin, më 5 nëntor 1912

77

- 2 -

Telegram i ambasadorit Szögyény dërguar ministrit të tij, kontit Berchtold, lidhur me qëndrimin e ministrit të Jashtëm italian San Giuliano për të mos pranuar zgjerimin e Serbisë me toka shqiptare dhe daljen e saj në detin Adriatik

Berlin, më 5 nëntor 1912

78

- 3 -

Telegram i ambasadorit Szögyény dërguar ministrit të tij në Vjenë, kontit Berchtold, me të cilin informon për dëshirën e Romës për përsëritjen e Paktit Tripalësh duke i shtuar marrëveshjen e bërë më parë për Shqipërinë dhe Novi Pazarin

Berlin, më 5 nëntor 1912^a

79

- 4 -

Telegram i Szögyény-t, ambasadorit austro-hungarez në Berlin, dërguar ministrit të tij Berchtold, me të cilin informon për mbështetjen e Gjermanisë që të pengohet zgjerimi i Serbisë drejt Adriatikut duke aneksuar vise shqiptare

Berlin, më 5 nëntor 1912

80

- 5 -

Telegram i ambasadorit austro-hungarez në Londër Mensdorff, dërguar MP të Jashtme, lidhur me prononcimin e Edward Grey-t, sekretarit të shtetit për Punët e Jashtme të Britanisë së Madhe, për një Shqipëri autonome, por me kufi të diskutueshëm

Londër, më 5 nëntor 1912

81

- 6 -

Raport i ambasadorit austro-hungarez në Romë, Mérey, lidhur me këmbënguljen e Romës për të përfshirë në Paktin Tripalësh, marrëveshjen dypalëshe për Shqipërinë

Romë, më 5 nëntor 1912

82

- 7 -

Raport dite mbi një vizitë të ambasadorit rus te konti Berchtold, ministri i Jashtëm i Austro-Hungarisë, dhe rreth trajtimit në bisedën e tyre të çështjes së daljes së Serbisë në bregetin e Adriatikut

Budapest, më 5 nëntor 1912

82

- 8 -

Telegram i ambasadorit austro-hungarez në Peterburg, Thurn, dërguar kontit Berchtold, lidhur me këmbënguljen e ministrit rus Sazanov për t'u marrë në konsideratë aspiratat e Serbisë për daljen në Adriatik në bregdetin shqiptar

Peterburg, më 5 nëntor 1912

83

- 9 -

Njoftim i konsullit austro-hungarez në Korfuz, dërguar kontit Berchtold, me të dhëna për emrin dhe itenerarin e udhëtimit të princit rumun me origjinë shqiptare Albert Gjika

Korfuz, më 5 nëntor 1912

86

- 10 -

Letër e Dervish Himës dërguar nga Stambolli konsullit të përgjithshëm austro-hungarez në Vjenë, Rappaport, me të dhëna për veprimtarinë e tij, të studentëve shqiptarë dhe të Ismail Qemalit

Konstantinopojë, më 5 nëntor 1912

86

- 11 -

Telegram i kontit Berchtold, ministër i jashtëm i Austro-Hungarisë, dërguar ministrit të tij në legatën e Athinës, me udhëzimin për të kundërshtuar bllokimin e bregdetit shqiptar nga flota greke

Budapest, Vjenë më 6 nëntor 1912

88

- 12 -

Telegram i ambasadorit austro-hungarez në Berlin, Szögyény, dërguar kontit Berchtold, me të cilin informon rreth sondazheve të përfaqësuesve të Parisit dhe Londrës për të njohur pikëpamjen e Gjermanisë lidhur me kërkesën e Serbisë për dalje në Adriatik, si dhe rreth qëndrimit të diplomatit gjerman

Berlin, më 6 nëntor 1912

89

- 13 -

Njoftim i ambasadorit austro-hungarez në Gjermani, Szögyény, lidhur me bindjen e zyrtarëve të atjeshëm se Turqia është tepër e dobët përballë aleatëve ballkanas dhe se dëshira e Ruisë për t'i lënë Turqisë Stambollin dhe Edernenë mund të shfrytëzohet që ajo të hedhë poshtë kërkesën e Serbisë për të dalë në Adriatik

Berlin, më 6 nëntor 1912

89

- 14 -

Raport i përfaqësuesit austro-hungarez në legatën në Rumani, K.E. Fürstenberg, me të cilin informon eprorët për pikëpamjen e Ruisë rreth copëtimit të territoreve të Perandorisë Osmane

Bukuresht, më 6 nëntor 1912

90

- 15 -

Telegram i përfaqësuesit të Austro-Hungarisë në Francë, ambasadorit Szécsen, lidhur me qëndrimin e kryeministrit francez Poincaré për synimet e Serbisë dhe të ardhmen e Shqipërisë

Paris, më 6 nëntor 1912

91

- 16 -

Njoftim nga Bukureshti mbërritur në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, përmes Vlorës, me vlerësime për Ismail Qemalin dhe Luigj Gurakuqin dhe me të dhëna për projektin e tyre për të ardhmen e Shqipërisë dhe situatën aty

Vlorë, më 6 nëntor 1912

91

- 17 -

Informacion i konsullit austro-hungarez në Vlorë, Lejhanec, për ambasadorin Pallavicini në Stamboll, lidhur me shqetësimin e Eqrem Vlorës për ngecjen e të atit, Syrja bej Vlorës, në Shkodër dhe për mundësinë e drejtimit prej Ismail Qemalit të Kuvendit që do të mbahej në Vlorë

Vlorë, më 6 nëntor 1912

93

- 18 -

Informacion i konsullit austro-hungarez në Vlorë, Lejhanec për ministrin Berchtold lidhur me shqetësimin e Eqrem Vlorës për ngecjen e të atit Syrja Vlorës në Shkodër dhe mundësinë e drejtimit të Kuvendit që do të mbahej në Vlorë prej Ismail Qemalit

Vlorë, më 6 nëntor 1912

94

- 19 -

Telegram sekret i ambasadorit austro-hungarez në Berlin, Szögyény, me të cilin informon Berchtoldin për qëndrimin e kreut të diplomacisë italiane rreth kërkesës së Serbisë për të dalë në Adriatik dhe për ekspozimin prej tij, në bisedë me ambasadorin e Francës, të marrëveshjes sekrete Itali - Austro-Hungari për çështjen shqiptare

Berlin, më 7 nëntor 1912

95

- 20 -

Telegram sekret i ambasadorit austro-hungarez në Gjermani, Szögyény, drejtuar MP të Jashtme, lidhur me bisedën me sekretarin e Shtetit të Gjermanisë, Kiderlen, rreth reagimeve serbe e ruse ndaj qëndrimit të Vjenës për kundërshtimin e synimit të Serbisë për të siguruar dalje në bregdetin e Adriatikut

Berlin, më 7 nëntor 1912

96

- 21 -

Komunikatë telefonike e princit, Hohenlohe*, mbi një vizitë të ambasadorit rus Giers** në Ministrinë e Punëve të Jashtme për interesimin e tij rreth pikëpamjes austro-hungareze për zgjidhjen e krizës ballkanike, posaçërisht për qëndrimin ndaj kërkesës së Serbisë për të siguruar dalje në bregdetin e Adriatikut

Budapest, më 7 nëntor 1912^a

97

- 22 -

Telegram nga ambasadori austro-hungarez në Peterburg, Thurn, me të cilin informon kontin Berchtold se masat e forta për të penguar daljen e Serbisë në Adriatik mund të shkaktojnë konflikt të armatosur me Rusinë

Beograd, më 7 nëntor 1912

98

- 23 -

Telegram i ambasadorit të Austro-Hungarisë në Rusi, Thurn, për trajtimin nga media ruse të problemit të krijuar nga dëshira e Serbisë për të dalë në bregdetin e Adriatikut

Peterburg, më 7 nëntor 1912

99

- 24 -

Telegram i ministrit të Austro-Hungarisë në legatën në Bullgari, Tarnóvski, me të cilin njofton për vizitën që do të bëjë atje kryetari i parlamentit bullgar z. Danev dhe synimin e tij për diskutimin e çështjeve rajonale

Sofje, më 7 nëntor 1912

99

- 25 -

Njoftim i Bilinskit, nga konsullata austro-hungareze në Janinë, për ministrin e Jashtëm, Berchtold, rreth një telegrami që paria e vendit u dërgonte arqipeshkvit të Shkodrës, të Durrësit dhe popullsisë së Pejës e Gjakovës

Janinë, më 7 nëntor 1912

100

- 26 -

Shtojca e informacionit të Bilinskit nga konsullata austro-hungareze në Janinë, për kontin Berchtold, me përmbajtjen e telegramit të parisë së Janinës, dërguar arqipeshkvit shqiptar të Shkodrës

Janinë, më 7 nëntor 1912

100

- 27 -

Njoftim i nënkonsullit austro-hungarez në Durrës, Rudnay, për ministrin e Jashtëm, Berchtold, lidhur me shqetësimin e shqiptarëve për avancimin e ushtrive serbe e malazeze, si edhe rreth përgatitjes së një lutjeje ku do të kërkohet mbrojtja e Austro-Hungarisë

Durrës, më 7 nëntor 1912

101

- 28 -

Konsulli austro-hungarez, Zambaur, njofton ministrin e Jashtëm, kontin Berchtold, për mbërritjen në Shkodër më 1 nëntor të Syrja bej Vlorës, për pikëpamjet e tij për situatën, si edhe për thirrjen në Vlorë të një kuvendi të patriotëve shqiptarë

Shkodër, më 7 nëntor 1912

102

- 29 -

Telegram shifër i Bilinskit nga Janina për ministrin e Jashtëm, kontin Berchtold, lidhur me veprimtarinë e dukshme të atdhetarëve shqiptarë për bashkëpunim kundër copëtimit të trojeve shqiptare, për organizimin e një kongresi dhe për të kërkuar mbështetjen e Austro-Hungarisë

Janinë, më 7 nëntor 1912

103

- 30 -

Letër e Dervish Himës drejtuar Konsullit të përgjithshëm të Austro-Hungarisë në Vjenë, Rappaport, me të cilën njofton për takimet e tij me autoritetet osmane me origjinë shqiptare, për ekzistencën në këto rrethe të idesë për të çuar një delegacion në Evropë, mandej për veprimtarinë për organizimin e studentëve shqiptarë në Stamboll, si dhe për opinionin lidhur me vlerësimin që po gjen politika e Perandorisë Habsburge ndër shqiptarët

Konstandinopojë, më 7 nëntor 1912

104

- 31 -

Telegram tepër sekret i Braunit nga legata e Austro-Hungarisë në Athinë, dërguar eprorëve, lidhur me prononcimin e ministrit të jashtëm grek, Koromilas, për synimet territoriale të Greqisë

Athinë, më 8 nëntor 1912

105

- 32 -

Telegram nga Vjena i kontit Berchtold, lidhur me ankesat e Beogradit ndaj konsullit të Austro-Hungarisë në Prizren, që akuzohet si nxitës i rezistencës kundër pushtimit serb

Vjenë, më 8 nëntor 1912

106

- 33 -

Telegrami i kontit Berchtold për ministrin austro-hungarez, Ugron, në legatën e Beogradit, lidhur me qëndrimin zyrtar që duhet t'i komunikojë kryeministrit serb Nikola Pašić

Budapest, Vjenë, më 8 nëntor 1912

106

- 34 -

Telegram vijues i Berchtoldit për diplomatët e Austro-Hungarisë në Berlin dhe Beograd, për të siguruar sinkronizimin me Gjermaninë në politikën ndaj Serbisë

Budapest, Vjenë, më 8 nëntor 1912

107

- 35 -

Telegram sekret i ambasadorit austro-hungarez, Szögyény, nga Berlioni, për ministrin Berchtold lidhur me përpjekjet për marrëveshje midis Italisë, Gjermanisë dhe Austro-Hungarisë për çështjen e Shqipërisë

Berlin, më 8 nëntor 1912

108

- 36 -

Raport konfidencial për kontin Berchtold i ambasadorit austro-hungarez në Londër, Mensdorff, rreth pikëpamjes britanike për trajtimin e çështjes shqiptare, të shprehur nga mbreti George

Londër, më 8 nëntor 1912

109

- 37 -

Raport i ambasadorit austro-hungarez Mensdorff, me të cilin informon nga Londra për pikëpamjen britanike të shprehur nga sekretari i Punëve të Jashtme Edward Grey, në një takim të dytë brenda dy ditësh rreth çështjes shqiptare

Londër, më 8 nëntor 1912

110

- 38 -

Telegram i Berchtoldit, ministër i Jashtëm i Austro-Hungarisë, për ambasadorin në Romë, me udhëzime për trajtimin e çështjes shqiptare në akord me ministrin e Jashtëm të Italisë, markezin di San Giuliano

Budapest, Vjenë, më 8 nëntor 1912

111

- 39 -

Telegram i përsëritur i ministrit Berchtold, dërguar për njoftim disa përfaqësive diplomatike austro-hungareze, posaçërisht ambasadorit Thurn në Petërburg, lidhur me qëndrimet që duhen mbajtur për çështjen shqiptare në përgjithësi dhe për aspiratat aneksioniste të Serbisë

Budapest, Vjenë, më 8 nëntor 1912

112

- 40 -

Telegram i Berchtoldit për disa përfaqësi diplomatike austro-hungareze, në të cilin evidentohet mirëkuptimi me Gjermaninë, si edhe roli i Rusisë për nxitjen e agresivitetit të shteteve të Ballkanit

Budapest, Vjenë, më 8 nëntor 1912

113

- 41 -

Telegram i shifruar i Berchtoldit ministrit të Jashtëm të Austro-Hungarisë për nënkonsullin Rudnay në Durrës, me të cilin kërkon të nxiten shqiptarët të manifestojnë vullnetin e tyre për mbrojtjen e integritetit të vendit

Durrës, më 8 nëntor 1912

114

- 42 -

Njoftim i ambasadorit austro-hungarez në Washington, Zvidenek, për kontin Berchtold, lidhur me një lutje të priftërinjve shqiptarë në SHBA drejtuar sinodit rus, që të ndikojë në mbrojtjen e territoreve dhe të kombit shqiptar të rrezikuar nga aleatët e krishterë ballkanas

Washington, më 9 nëntor 1912

114

- 43 -

Raport dite mbi vizitën e ministrit fuqiptotë të Greqisë, Streit, në ministrinë e Jashtme të Austro-Hungarisë, mbi opinionin e tij për politikën e Austro-Hungarisë për çështjen shqiptare dhe mbi sondazhet e tij për të konfirmuar qëndrimet e Perandorisë Habsburge rreth aspiratave të aleatëve ballkanas

Athinë, më 9 nëntor 1912

115

- 44 -

Telegrami i ambasadorit austro-hungarez në Londër, Mesendorff, me informacion për qëndrimin e sekretarit të Shtetit britanik për Punët e Jashtme, E. Grey, rreth autonomisë së Shqipërisë, territorit të saj dhe aspiratës së Serbisë për dalje në Adriatik

Londër, më 9 nëntor 1912

116

- 45 -

Raport i ambasadorit austro-hungarez Szécsen, nga Parisi, rreth qëndrimit të kryeministrit francez Raymond Poincaré lidhur me kërkesën e Serbisë për dalje në Adriatik, si edhe rreth qëndrimit agresiv të Vesnić-it përfaqësuesit serb në Francë

Paris, më 9 nëntor 1912

117

- 46 -

Telegram sekret i ambasadorit të Austro-Hungarisë në Itali, Mérey, me të cilin informon Vjenën për qëndrimin e ngjashëm të shprehur nga ministri i Jashtëm italian, markezi di San Giuliano, rreth trajtimit të së ardhmes politike e territoriale të Shqipërisë, si edhe për nevojën e kundërshtimit jo vetëm të aspiratave aneksioniste të Serbisë, por edhe të Greqisë e Malit të Zi

Romë, më 9 nëntor 1912

118

- 47 -

Telegram i Berchtoldit për ambasadorin austro-hungarez në Peterburg, Thurn, që të sqarojë qëndrimin e luhatsëm të ministrit të Jashtëm të Rusisë, Sazanovit, rreth çështjes së daljes së Serbisë në det

Budapest, Vjenë, më 9 nëntor 1912

119

- 48 -

Telegram i ambasadorit austro-hungarez, Thurn, nga Peterburgu për ministrin Berchtold, lidhur me punën që po bën duke bashkëpunuar me ambasadorin gjerman, për të saktësuar qëndrimin e Ruisë ndaj aspiratave të Serbisë për tokat shqiptare

Peterburg, më 9 nëntor 1912

120

- 49 -

Telegram i ambasadorit Thurn nga Peterburgu drejtuar ministrit Berchtold, lidhur me informatat e tij të siguruara nga ambasadori gjerman Pourtalès, për qëndrimin rus ndaj çështjes së pretendimeve të Serbisë

Peterburg, më 9 nëntor 1912

121

- 50 -

Raport i ambasadorit austro-hungarez, Thurn, nga Peterburgu për ministrin e Jashtëm Berchtold, lidhur me qëndrimet e Ruisë dhe Francës, por edhe të Italisë, ndaj aspiratës serbe për të dalë në Adriatik duke aneksuar vise shqiptare

Peterburg, më 9 nëntor 1912

122

- 51 -

Raport i ambasadorit austro-hungarez, Thurn, nga Peterburgu, me të cilin njofton lidhur me situatën e ndezur në Rusi kundër Austro-Hungarisë për shkak të kundërshtimit të saj për daljen e Serbisë në Adriatik

Peterburg, më 9 nëntor 1912

123

- 52 -

Telegrami i ministrit fuqiptotë të Austro-Hungarisë në Sofje, i cili informon agresivitetin e përfaqësuesit diplomatik serb dhe pikëpamjen e atij italian lidhur me aspiratën serbe për dalje në Adriatik duke aneksuar vise shqiptare

Sofje, më 9 nëntor 1912

123

- 53 -

Telegram i ministrit fuqiptotë të Austro-Hungarisë në Beograd, Ugronit, lidhur me takimin me kryeministrin e Serbisë, Nikola Pašić-in dhe këmbënguljen e tij për aneksimin e territoreve shqiptare, që do të siguronin daljen portuale në detin Adriatik

Beograd, më 10 nëntor 1912

124

- 54 -

Telegram i ministrit fuqiptotë të Austro-Hungarisë, Ugron, nga Beogradi, me të cilin informon për qëndrimin e kryeministrit serb N.Pašić lidhur me çështjen e daljes së Serbisë në Adriatik, të deklaruar diplomatit përfaqësues të Italisë atje

Beograd, më 10 nëntor 1912

125

- 55 -

Raport i ministrit fuqiptotë të Austro-Hungarisë në Beograd, Ugron, adresuar Vjenës, me të cilin informon për intrigat e ambasadorit rus atje, që i nxit serbët të jenë agresivë, provokatorë dhe të palëkundur në kërkesat e tyre

Beograd, më 10 nëntor 1912

126

- 56 -

Raport i përfaqësuesit diplomatik austro-hungarez në Serbi, Ugron, dërguar ministrisë së Jashtme në Vjenë, lidhur me një kryeartikull të gazetës "Samouprava", në të cilën atakohet politika e Perandorisë Habsburge, si kundërshtarja kryesore e aspiratave serbe

Beograd, më 10 nëntor 1912

127

- 57 -

Telegram i kontit Berchtold për ministrin fuqiptotë të Austro-Hungarisë në Cetinë, për t'i komunikuar mbretit Nikolë se shteti i tij nuk do të lejojë aneksimin e bregdetit shqiptar nga Mali i Zi ose Serbia

Budapest, Vjenë, më 10 nëntor 1912

127

-58-

Telegram i ambasadorit të Austro-Hungarisë në Francë, Szécsen, përmes të cilët informon Berchtoldin se mediat e afërta me politikën zyrtare franceze, kanë vlerësuar politikën austro-hungareze në Ballkan, duke kërkuar uljen e toneve për të shmangur europianizimin e konfliktit ballkanik

Paris, më 10 nëntor 1912

128

- 59 -

Telegrami i ministrit të Austro-Hungarisë, Berchtold, dërguar përfaqësive diplomatike në Romë dhe Londër, me udhëzimin për të përdorur në bisedimet me markezin di San Giuliano dhe Z. Edward Grey disa formulime standarde, që përfaqësojnë qëndrimin zyrtar të Vjenës ndaj kërkesave të Serbisë

Budapest, Vjenë, më 10 nëntor 1912

129

- 60 -

Telegram i Berchtoldit, ministër i Jashtëm i Austro-Hungarisë për ambasadorin në Romë lidhur me instruksionet e dhëna baronit Giesl në Cetinë, rreth qëndrimit zyrtar që duhet mbajtur për pushtimin e Shëngjinit dhe Lezhës nga malazezët

Budapest, Vjenë, më 10 nëntor 1912

130

- 61 -

Telegram i ambasadorit austro-hungarez në Rusi, Thurn, drejtor i kontit Berchtold, me informacion për qëndrimin e ministrit të Jashtëm rus Sazanovit, rreth aspiratës së Serbisë për të siguruar një liman në bregdetin e Adriatikut

Peterburg, më 10 nëntor 1912

131

- 62 -

Raport dite i konceptuar nga Nemes e Berchtold, mbi një intervistë të diplomatit austro-hungarez, Pogatscher, dhe qëndrimin e Bullgarisë ndaj pretendimeve të shteteve ballkanike me zotën Danev, kryetarin e parlamentit bullgar, për situatën në Ballkan

Budapest, më 10 nëntor 1912^a

132

- 63 -

Intervistë e diplomatit austro-hungarez, Rudolf Pogatscher, me kryetarin e parlamentit bullgar, z. Danev, rreth situatës në Ballkan etj., dhe rreth qëndrimit të Bullgarisë ndaj pretendimeve të Serbisë për daljen në Adriatik

Budapest, më 10 nëntor 1912^a

133

- 64 -

Raport dite mbi vizitën e ministrit fuqiplotë të Serbisë, Simić, për të paraqitur para Ballplatzit, pikëpamjet e qeverisë së tij për domosdoshmërinë e copëtimit të Shqipërisë midis Serbisë e Greqisë në interes të paqes në Ballkan

Vjenë, më 11 nëntor 1912

133

- 65 -

Telegrami i ministrit fuqiplotë të Austro-Hungarisë në Beograd, Ugron, me të cilin informon për prononcimin dhe pikëpamjet e kryediplomatit britanik në Beograd, Ralph, lidhur me çështjen e pretendimeve serbe për daljen në Adriatik

Beograd, më 11 nëntor 1912

135

- 66 -

Telegram i ambasadorit të Austro-Hungarisë në Berlin, Szögyény, me anën e të cilit informon për prononcimin jozyrtar të të ngarkuarit me punë të Serbisë atje se shteti i tij do të preferonte daljen në Egje, krahasuar me atë në Adriatik, nëse për këtë nuk do të pengonin Bullgaria e Greqia

Berlin, më 11 nëntor 1912

136

- 67 -

Telegram i Berchtoldit, ministrit të Jashtëm të Austro-Hungarisë, drejtuar ambasadorit Mensdorff në Londër, lidhur me aktivizimin e diplomacisë angleze në çështjen e krijimit të një Shqipërie autonome, pavarësisht ecurisë së operacioneve luftarake në Ballkan

Budapest, Vjenë, më 11 nëntor 1912

137

- 68 -

Telegram nga ambasadori i Austro-Hungarisë në Londër, Mensdorff për kontin Berchtold, lidhur me qëndrimin e diplomatëve britanikë, rusë dhe francezë, si edhe të shtypit londinez rreth çështjes shqiptare, shoqëruar me sugjerimin për nevojën e ndërmarrjes së ndonjë manifestimi politik nga vetë shqiptarët

Londër, 11 nëntor 1912

138

- 69 -

Telegram i ambasadorit austro-hungarez, Szécsen, të akredituar në Paris, drejtuar Berchtoldit, përmes të cilit përcjell informacionet e ambasadorit gjerman, që dëshmojnë për qëndrim të njëjtë dhe për përpjekje për presion ndaj Serbisë agresive me anën e kryeministrit francez, Poincaré

Paris, më 11 nëntor 1912

138

- 70 -

Telegram i ambasadorit të Austro-Hungarisë në Paris, me informacionin për argumentet e paraqitura kryeministrit francez, Poincaré, se përse Serbia nuk duhet të dalë në Adriatik

Paris, më 11 nëntor 1912

139

- 71 -

Telegram i ambasadorit Mérey, nga Roma, për kontin Berchtold, lidhur me qëndrimin italian për autonominë e Shqipërisë dhe qëndrimin francez e anglez për çështjen e daljes së Serbisë në Adriatik

Romë, 11 nëntor 1912

140

- 72 -

Telegram i ambasadorit austro-hungarez në Rusi, Thurn, drejtuar kontit Berchtold, me informacion rreth bisedës me kryeministrin rus, Kokovzov, për çështjen e Shqipërisë dhe pretendimet e Serbisë

Peterburg, më 11 nëntor 1912

141

- 73 -

Telegram i Thurnit, ambasador i Austro-Hungarisë në Rusi dërguar ministrit Berchtold, lidhur me qëndrimin e Sazanovit për çështjen e daljes së Serbisë në detin Adriatik ose Egje

Peterburg, më 11 nëntor 1912

142

- 74 -

Telegram i ministrit të Jashtëm të Austro-Hungarisë, kontit Berchtold dërguar përfaqësuesit diplomatik në Sofje, lidhur me pikëpamjen e Danevit, kryetarit të parlamentit bullgar, për çështjen e krijimit të një Shqipërie autonome dhe dëshirën e Serbisë për daljen në Adriatik

Budapest, më 11 nëntor 1912

143

- 75 -

Kërkesë e një shqiptari, që kishte shërbyer dikur në kryekonsullatën e Austro-Hungarisë në Shkodër, drejtuar me sa duket Ministrisë së Jashtme në Vjenë, me ofertën për të shërbyer për çdo mision që do t'i ngarkohej

Kotorr, më 11 nëntor 1912

144

- 76 -

Telegram shifër i nënkonsullit të Austro-Hungarisë në Durrës, Rudnay, me të cilin informon një vapor të Lloyd-it në Kastelnuovo dhe kryekonsullatën në Shkodër për mbërritjen aty kalimthi të disa personaliteteve shqiptare, nga treva të ndryshme

Durrës, më 11 nëntor 1912

146

- 77 -

Informacion tepër konfidencial i konsullit austro-hungarez, Zambaur, dërguar nga Shkodra ministrit Berchtold, lidhur me veprime të lëkundura të Preng Bib Dodës, dhe reputacionin e dobët që ai gëzon në Malësinë e Madhe

Regjistruar më 11 nëntor 1912

146

- 78 -

Telegram-shifër i konsullit Zambaur, dërguar nga Shkodra, përfaqësisë së Austro-Hungarisë në Kotorr dhe ambasadës në Stamboll, me njoftimin për mbërritjen aty nga Pireu të konsullit të përgjithshëm të Italisë, kontit Mancinelli

Shkodër, më 11 nëntor 1912

148

- 79 -

Njoftim konfidencial i nënkolonelit A.B. Novak* drejtuar disa ministrive dhe arqidukës Franz Ferdinandit*, lidhur me përmbajtjen e një telegrami të muajit shtator, për përpjekjet e Italisë për të joshur Preng Bib Dodën, dhe të Malit të Zi për të lehtësuar okupimin e Shkodrës dhe viseve të tjera shqiptare duke vepruar përmes Preng Bib Dodës dhe Sokol Bacit

Vjenë, më 11 nëntor 1912

148

- 80 -

Telegram i ministrit Berchtold për përfaqësuesit e Austro-Hungarisë në Romë dhe Peterburg, lidhur me qëndrimet e Italisë dhe Rusisë për çështjen e aspiratës së Serbisë për të siguruar një liman në Adriatik

Budapest, Vjenë, më 12 nëntor 1912^a

150

- 81 -

Telegram i përfaqësuesit të Austro-Hungarisë në Romë, Mérey, drejtuar ministrit Berchtold lidhur me qëndrimin e ngjashëm të qeverisë italiane, paraqitur Malit të Zi

Romë, më 12 nëntor 1912

151

- 82 -

Telegram i ambasadorit austro-hungarez në Rusi, Thurn, drejtuar kontit Berchtold, lidhur me qëndrimin rus për çështjen shqiptare dhe aspiratat serbe

Peterburg, më 12 nëntor 1912

151

- 83 -

Raport i ambasadorit Thurn nga Peterburgu për ministrin Berchtold, lidhur me nuancat në qëndrimin e Rusisë ndaj aspiratës së Serbisë për të siguruar dalje në bregdetin e Adriatikut

Peterburg, më 12 nëntor 1912

152

- 84 -

Raport i ambasadorit austro-hungarez në Rusi, Thurn, drejtuar ministrit Berchtold, lidhur me presionin indirekt të diplomacisë ruse që të pranohet kërkesa e Serbisë për të siguruar dalje portuale në Adriatik
Peterburg, më 12 nëntor 1912

154

154

- 85 -

Telegram i ministrit Tarnóvski nga legata e Austro-Hungarisë në Sofje, për ministrin Berchtold, lidhur me qëndrimin agresiv ekstrem të Serbisë të deklaruar nga ambasadori i saj atje dhe solidarizimin e ambasadorit të Italisë me qëndrimin austro-hungarez për çështjen e autonomisë së Shqipërisë
Sofje, më 12 nëntor 1912

154

- 86 -

Raport dite i përgatitur në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë mbi vizitën atje të Ismail Qemalit dhe mbi kërkesën e tij që Vjena të përkrahë aspiratat e njohura të shqiptarëve
Vjenë, më 12 nëntor 1912

155

- 87 -

Telegram i Braunit nga Stambolli drejtuar ministrit të Jashtëm, Berchtold, rreth pronocimit të ministrit grek Koromilas, lidhur me aspiratën greke për Selanikun
Stamboll, më 12 nëntor 1912

156

- 88 -

Telegrami i përfaqësuesit diplomatik austro-hungarez në Beograd, Ugron, lidhur me pronocimin konfidencial të kryediplomatit britanik atje, se një hekurudhë dhe port neutral në Adriatik, që do të përdreshin nga Serbia, mund të ishte zgjidhja konsensuale e konfliktit
Beograd, më 12 nëntor 1912

157

- 89 -

Telegram i ministrit austro-hungarez, Ugron, nga legata në Beograd, me të cilin njofton kontin Berchtold për rritjen e pretendimeve të aleatëve ballkanas për të copëtuar midis tyre të gjithë Shqipërinë
Beograd, më 12 nëntor 1912

157

- 90 -

Raport i diplomatit austro-hungarez, Fürstenberg, nga Bukureshti lidhur me qëndrimin e Rumanisë për çështjen e Shqipërisë dhe të daljes së Serbisë në bregdetin e Adriatikut

Bukuresht, më 12 nëntor 1912

158

- 91 -

Raport i ministrit të Austro-Hungarisë në legatën në Cetinë, Giesl, për ministrin Berchtold, lidhur me qëndrimin e Mbretit Nikolë ndaj presionit të Vjenës për të mos pushtuar më tej vise shqiptare

Cetinë, më 12 nëntor 1912

159

- 92 -

Telegram shifër i nënkonsullit të Austro-Hungarisë në Durrës, von Rudnay, me destinacion Budapestin, ambasadën në Stamboll dhe kryekonsullatën në Shkodër, me të cilin informon për situatën dhe rolin e tij në përgatitjet për Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë

Durrës, më 12 nëntor 1912

161

- 93 -

Buletin ditor lidhur me qëndrimin e mbajtur në Ministrinë e Jashtme të Austro-Hungarisë ndaj Ismail Qemalit, me rastin e vizitës së tij në Vjenë

Vjenë, më 12 nëntor 1912

162

- 94 -

Telegram i nënkonsullit Rudnay nga Durrësi lidhur me lëvizjet e Syrja bej Vlorës dhe ofertën e tij për t'i dhënë Austro-Hungarisë Shkodrën

Durrës, më 12 nëntor 1912

163

- 95 -

Telegram i shifruar i nënkonsullit të Austro-Hungarisë në Durrës, Rudnay, me të cilin njofton për telegramin e Ismail Qemalit, që garanton të ardhmen e Shqipërisë dhe kërkon mbledhjen në Vlorë të delegatëve të Kongresit Kombëtar

Durrës, më 12 nëntor 1912

164

- 96 -

Telegram i shifruar i ministrit Berchtold për nënkonsullin Rudnay në Durrës, me kërkesën për të informuar vendndodhjen e Eqrem bej Vlorës

Vjenë, më 12 nëntor 1912

164

- 97 -

Letër e Artur Rablerit drejtuar nga Vjena Dervish Himës, me të cilën rekomandon që shqiptarët të shpallin përmes shtypit evropian vendimin për ruajtjen e integritetit territorial të Shqipërisë

Vjenë, më 12 nëntor 1912

165

- 98 -

Telegram i ministrit fuqiptotë të Austro-Hungarisë në Athinë, Braun, drejtuar kontit Berchtold, me të cilin informon se qëndrimi i Vjenës, për t'i ofruar Serbisë Selanikun në vend të një porti në Adriatik ka shkaktuar një acarim ekstrem

Athinë, më 13 nëntor 1912

165

- 99 -

Telegram i diplomatit austro-hungarez në Cetinë, Giesl, për eprorët në Vjenë, lidhur me qëndrimin italian ndaj synimeve të shfaqura nga Nikola i Malit të Zi

Cetinë, më 13 nëntor 1912

166

- 100 -

Telegram i ambasadorit të Austro-Hungarisë në Londër, Mensdorff, drejtuar ministrit Berchtold lidhur me qëndrimin e ekuilibruar të Edward Grey-t dhe presionin e tij ndaj Beogradit për të mos këmbëngulur për daljen doemos në Adriatik përmes aneksimit të viseve shqiptare

Londër, më 13 nëntor 1912

167

- 101 -

Telegram i ambasadorit austro-hungarez Mensdorff nga Londra, drejtuar Berchtold-it, ministrit të tij të Punëve të Jashtme, lidhur me qëndrimin e E. Grey-t për çështjen e statusit dhe të kufijve të Shqipërisë etj.

Londër, më 13 nëntor 1912

168

- 102 -

Telegram i diplomatit austro-hungarez në Sofje, Tarnówskit, drejtuar eprorëve në Vjenë, lidhur me luhatjet e Geshovit para presionit për të mos përkrahur kërkesën e Serbisë për të siguruar daljen në Adriatik në territorin shqiptar

Sofje, më 13 nëntor 1912

168

168

- 103 -

Raport i konsullit Lejhanec nga Vlora për kontin Berchtold, ministër i Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, lidhur me veprimtarinë e Syrja dhe Eqrem Vlorës në rivalitet me Ismail Qemalin, për të organizuar një kuvend kombëtar të përgjithshëm në ndonjë qytet të Shqipërisë Perëndimore

Vlorë, më 13 nëntor 1912 170

- 104 -

Shtojca e raportit të mësipërm, Nr. 64 datë 13 nëntor, e konsullit Lejhanec, e cila përmban kopjet e telegramit të Ismail Qemalit dërguar nga Vjena të birit, Ethem Beut në Vlorë më 9 nëntor dhe përgjigjen e tij

Vlorë, më 13 Nëntor 1912 171

Kopje e një telegrami të Ismail Qemal bej Vlorës drejtuar të birit të tij Ethem Beut në Vlorë (teksti frëngjisht)

Vjenë, më 9 nëntor 1912 171

Kopje e një telegrami falënderimi të Ethem bej Vlorës drejtuar të atit të tij Ismail Qemal beut në Vjenë (teksti frëngjisht)

Vlorë, 13 nëntor 1912 171

- 105 -

Telegram i shifruar i nënkonsullit të Austro-Hungarisë në Durrës, Rudnay, me të cilin informon situatën jo të përshtatshme në këtë qytet, për mbajtjen e një kongresi kombëtar të shqiptarëve dhe nxitjen prej tij të delegatëve të mbledhur për nënshkrimin e një lutjeje, ku përveç autonomisë, të figurojnte edhe varianti i "pavarësisë"

Durrës, më 13 nëntor 1912 172

- 106 -

Raport i nënkonsullit Rudnay dërguar telegrafisht nga Durrësi ministrit Berchtold, lidhur me mbledhjen e një numri delegatësh në këtë qytet nën kujdesin e Dom Nikoll Kaçorrit dhe Murat Toptanit dhe hartimin ilegalisht prej tyre të një dokumenti ku shënohej se, nëse autonomia nën sundimin turk ishte e pamundur, kërkohej "pavarësia dhe neutraliteti"

Durrës, më 13 nëntor 1912 173

-107-

Shtojcë e raportit të nënkonsullit Rudnay, të dt. 13 nëntor 1912, dërguar kontit Berchtold, me lutjen që disa delegatë shqiptarë të gjendur në Durrës, hartuan më 12 nëntor në gjuhën shqipe, për të kërkuar përkrahjen e Austro-Hungarisë në sigurimin e autonomisë ose pavarësisë së Shqipërisë

Durrës, më 13 nëntor 1912 175

- 108 -

Pjesë e shtojcës së raportit të nënkonsullit të Austro-Hungarisë në Durrës, Rudnay, për Vjenën, me emrat e delegatëve të kuvendit kombëtar të ndodhur në atë qytet, nënshkrues të Lutjes, drejtuar në gjuhën shqipe më 12 nëntor Perandorit Francez Jozef, për të mbështetur autonominë ose pavarësinë e Shqipërisë dhe integritetin e saj territorial

Durrës, më 13 nëntor 1912

177

- 109 -

Përfaqësuesi diplomatik i Austro-Hungarisë në Bari njofton ambasadorin në Romë dhe kontin Berchtold në Vjenë, rreth lëvizjeve të Preng Bib Dodës dhe synimin e tij për të shkuar në Shqipëri

Bari, më 13 nëntor 1912

177

- 110 -

Njoftim i konsullit austro-hungarez në Shkup, Heimroth, dërguar konsullit të përgjithshëm Rappaport në Vjenë, për situatën e krijuar në kuadrin e Luftës Ballkanike, e cila shoqërohet me kërkesën për t'u udhëzuar se ç' duhej bërë me arkivin politik të konsullatës

Shkup, më 13 nëntor 1912

178

- 111 -

Telegram i shifruar i nënkonsullit të Austro-Hungarisë në Durrës, Rudnay për kontin Berchtold, lidhur me lëvizjet e Eqrem bej Vlorës

Durrës, më 13 nëntor 1912

179

- 112 -

